



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:106433

Datë: 03.12.2020

Numri i dokumentit: 01316471

P.nr.539/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurve X. A dhe M. A që të dy nga fshati ... Komuna e ... për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.986/2020, të datës 04.09.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 18.11.2020 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 20.11.2020 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

1. Xh.A, nga babai S... dhe nëna E..., e lindur H...i lindur me datë ..., në fshatin ...Komuna e ... ku dhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i vetëpunësuar, me profesion bujk i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,
2. M. A nga babai Xh... dhe nëna H...e lindur Salihu,i lindur me datë ... në fshatin...Komuna e ..., ku dhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, me profesion bujk, punëtor në pastrimin kimik shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTOR

Sepse më datë 04.07.2020, rreth orës 14:00 h, në rrugën "...", në fshatin ... Komuna e ..., të pandehurit Xh. A dhe M. A në bashkëveprim, fizikisht e sulmojnë të dëmtuarin L. N nga fshat..., në atë mënyrë për derisa i dëmtuari ishte duke punuar- hap një kanal në pronën publike të fshatit, ndërsa në mes të pandehurit M... dhe të dëmtuarit L... kishte filluar një zënkë mes vete, ku i dëmtuari M... e sulmon të dëmtuarin L... duke e goditur me grushte në pjesë të ndryshme të trupit dhe pastaj në vend –ngjarje arrin edhe i pandehuri tjetër-babai i M...- Xh...i cili e ndihmon djalin e vet duke e goditur të dëmtuarin L... me shuplakë dhe grushte në trup, por për fatin e të dëmtuarit të njëjtit lëndime nuk i shkaktojnë, pastaj intervenojnë disa persona që ishin prezent dhe të njëjtit i ndajnë, në këtë mënyrë të pandehurit me veprimet e veta, me dashje, e kanë sulmuar dhe kanë përdorur forcën fizike ndaj të dëmtuari të sipër shënuar.

Me çka ka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,43,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 233, 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurit e lartcekur:

I GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë nga 200 € (dyqind) euro për secilin prej tyre veç e veç, të cilën gjobë të pandehurit e lartcekur obligohen ta paguajnë në afat prej 2 (dy) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje ta paguajnë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Meqenëse i dëmtuari L. N në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurve të lartcekur si dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike në këtë çështje penale juridike gjykata bazuar në të lartcekurat edhe nuk vendosi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Obligohen të pandehurit të lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 € (njëzet) euro si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 03.09.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.986/2020, kundër të pandehurve Xh. A dhe M. A që të dy nga fshati ...Komuna e ... për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe së bashku me aktakuzën kishin paraqitur edhe kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor ndaj të pandehurve mirëpo meqenëse gjykata ka çmuar se në rastin konkret të dhënat në aktakuzë nuk kanë ofruar bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe rrjedhimisht në kuptim të nenit 494 paragrafi 2 të KPP-ës ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Me datë 18.11.2020, pranë kësaj gjykate është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezent prokurorja e shtetit, i dëmtuari L. N si dhe të pandehurit Xh. A dhe M.A. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, të pandehurit të lartcekur, secili prej tyre veç e veç kishin deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi

aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 326 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve dhe rrjedhimisht seanca e shqyrtimit gjyqësor ka vazhduar me fjalët përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse në seancën e sotme të pandehurit kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë, pas njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë dhe se ky pranim i fajësisë është i mbështetur në provat tjera materiale bashkangjitur aktit akuzues, fakte këto dhe prova në bazë të të cilave në mënyrë të pa kontestueshme argumentohet fakti se tani të pandehurit kanë kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv aktakuzës lëndor për çka mbetet pranë asaj dhe propozimeve që i përmban e njëjta andaj edhe ka kërkuar gjykata që komfor dispozitave ligjore të njëjtit ti shpalle fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit ndërsa sa i përket caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka propozuar gjykatës që ti merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese me qëllim që dënimi të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve si dhe rrezikshmërinë e veprës penale.

I dëmtuari L. N në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe se nuk ka çfarë të shtoj tjetër.

I pandehuri Xh. A në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pendohet për veprimet e e tija, i kërkon falje të dëmtuarit për sjelljet e tij, i ka kërkuar falje edhe atëherë pas kryerjes së veprës penale, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, kurrë më parë me të dëmtuarin nuk kem pasur probleme as të tilla e as të natyrave të tjera me të njëjtin janë bashkëfshatarë, as nga ky rast më nuk kanë pasur probleme, tani më i kanë rregulluar raportet mes vete, ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla dhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehuri M.A në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pendohet për veprimet e tija, i kërkon falje publikisht të dëmtuarit për sjelljet e tija, nga ky rast por as më parë nuk kanë pasur probleme në mes vete, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, andaj ka kërkuar nga gjykata që tij shqiptojë një dënim sa me të butë.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve Xh. A dhe M. A

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë qenë prezente palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve të lartcekur për veprat penale për të cilat akuzohen ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e tyre nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e tyre, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë

mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-CA-..., i datës 30.06.2020, deklarata e të dëmtuarit, deklarata e dëshmitarëve si dhe deklarata e të pandehurve si dhe shkresat e tjera të lëndës po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë gjykata gjeti se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit Xh. A dhe M. A nga fshati ... Komuna e ..., kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurve të lartcekur secilit prej tyre duhet tu shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, këto dënime do të jenë të drejta, në harmoni me peshat e veprave penale dhe përgjegjësinë penale për secilin prej të pandehurve ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së derisa si rrethanë lehtësuese për të pandehurit Xh. A dhe M. A ka marrë faktin se të njëjtit e kanë pranuar fajësinë në një fazë të hershme të procedurës penale po ashtu si rrethane lehtësuese për të pandehurit gjykata ka marrë edhe faktin se secili prej të pandehurve janë penduar dhe kanë shfaqur keqardhje për veprimet e tyre duke i kërkuar falje të dëmtuarit, po ashtu të njëjtit por edhe vet i dëmtuari kanë deklaruar se tanimë i kanë rregulluar raportet mes vete dhe se të njëjti pas kryerjes së kësaj veprë penale nuk kanë pasur probleme mes vete por as më parë, faktin se secili prej tyre kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla e as vepra të tjera penale po ashtu gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për secilin prej tyre ka marrë edhe rrethanat personale dhe karakterin e tyre ku nga shkresat e lëndës shihet se për të njëjtit është hera e parë që bien ndesh me ligjin dhe më parë nuk kanë qenë të gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo veprë penale, po ashtu me rastin e caktimit të lartësisë së dënimeve me gjobë për secilin prej të pandehurve gjykata mori edhe gjendjen e tyre ekonomike ngase sipas deklarimeve të tyre del se të njëjtit janë të gjendjes së mesme ekonomike dhe rrjedhimisht me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata konsideron se asnjërit prej tyre por as familjarëve të tyre nuk u rrezikohet gjendja ekonomike ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit Xh .A dhe M.A gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur me kryerjen e veprës penale ngase në shkresat e lëndës shihet se të pandehurit këtë vepër e kanë kryer me dashje andaj që duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë gjykata konsideron se këto dënime janë të drejta dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve dhe se me këto dënime mund të arrihen edhe qëllimet e dënimit nga neni 38 të KPRK-së, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale,

shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata në bazë të nenit 451 të KPP-ës ka vendosur që secilin prej të pandehurve veç e veç ti detyrojë të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (njëzet) euro si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm,

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.539/2020, me datë 03.12.2020

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate themelore.